

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

**PUNIME NDIHMËSE NË MURATIM DHE
SUVATIME**

Kodi: PK-B-11-25

Njësia e të nxënit të standardit të kualifikimit “Ndërtim” , K-B-II-25, Niv II i KSHK-së:

1. NjN-02-II-0229-25 “Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime”

Niveli II i KSHK¹, referuar nivelit të II të KEK²

Miratoi:

MINISTRI

.....

- 1. Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
- 2. Korniza Europiane e Kualifikimeve

Certifikimi sipas Nivelit të II të KSHK-së për njësinë e të nxënit “Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime” me kod NjN-02-II-0229-25 do të jepet nga IoAFP i akredituar sipas Urdhërit nr. 845, datë 03.07.2025 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”.

Tiranë, 2025

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME NDIHMËSE NË MURATIM DHE SUVATIME

(PK-B-11-25)

I. Profili Profesional për puntor ndihmës në muratim dhe suvatime.

a) Karakteristikat e puntorit ndihmës në muratim dhe suvatime

Puntori ndihmës në muratim dhe suvatime do të jetë i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar në kompani ndërtimi, që kryejnë punime ndihmëse në muratim dhe suvatime. Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punëtori ndihmës në muratim dhe suvatime duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale në punime muratim dhe suvatime. Suksesi i punëtorit ndihmës të punimeve në muratim dhe suvatime është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj, sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale

Profesioni i punëtorit ndihmës në muratim dhe suvatime është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kryerjen e punimeve ndihmëse në muratim dhe suvatime.

Me përmbushjen e të gjithave njësive të të nxënimit të standardit të kualifikimit “Ndërtim” Niveli i II i KSHK-së, si dhe me përvojë pune, kursanti mund të kalojë në nivelet e metejshme të KSHK-së. Ky kurs i përgatit kursantet me kompetenca profesionale dhe aftësi të buta (soft skills) për të ushtruar disa veprimtari profesionale të përfshira në profesionin “Punëtorë të ndërtimit të banesave” me kod 9313, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime.

Në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime” kursantët do të jenë të aftë të:

- Ndihmojnë në organizimin e punës për muratim e suvatime;
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- Ndihmojnë në kryerjen e punimeve parapërgatitore;
- Ndihmojnë në realizimin e shtresës e parë të suvatimit;
- Ndihmojnë në realizimin e shtresës së dytë të suvatimit
- Ndihmojnë në realizimin e shtresës së tretë të suvatimit (finon)
- Parapërgatit materialet dhe pajisjet për muratim;
- Ndihmon në nivelimin e themeleve për muratim
- Ndihmon në organizimin e punës në muratim
- Ndihmon në ndërtimin e murit me tulla në lidhje në Formë “T” “L” dhe “+”.
- Ndihmon në ndërtimin e xokolit dhe murit në lartësi me gur natyror.
- Zbatojnë standardet e profesionit, gjatë punimeve ndihmëse në muratim e suvatim;
- Zbatojnë standardet e kodit të etikës në punë;

- Raportojnë për punën e kryer te eprorët, sipas proceseve të punës dhe formateve të kërkuara.
- Respektojnë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje” duhet të jenë mbi **16 vjeç** dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “ Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime”

141 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

IV. Modulet e Kursit “Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime”.

Nr	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e ndihmës në muratim e suvatim	MK-02- 402-25	21 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndihmës në muratim e suvatim 2. Kursanti interpreton lloje të ndryshme muratimi dhe suvatimi. 2. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
2	Punime parapërgatitore në muratim	MK-02- 403-25	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit materialet dhe pajisjet për muratim; 2. Kursanti ndihmon në nivelimin e themeleve për muratim
3	Punime parapërgatitore në suvatim	MK-02- 404-25	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në përgatitjen e materialeve për suvatim 2. Kursanti ndihmon në përgatitjen e sipërfaqeve për suvatim. 3. Kursanti ndihmon në parapërgatitjen e mjeteve për suvatime
4	Punime ndihmëse në muratim	MK-02- 405-25	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës në muratim. 2. Kursanti ndihmon në ndërtimin e murit me tulla në lidhje në Formë “T” “L” dhe “+”. 3. Kursanti ndihmon në ndërtimin e xokolit dhe murit në lartësi me gur natyror.

5	Punime ndihmëse në suvatim	MK-02- 406-25	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës për suvatim. 2. Kursanti ndihmon në realizimin e shtresës e parë të suvatimit. 3. Kursanti ndihmon në realizimin e shtresës së dytë të suvatimit. 4. Kursanti ndihmon në realizimin e shtresës së tretë të suvatimit (finon)
---	----------------------------	---------------	--	--

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MEI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Punime ndihmëse në muratim dhe suvatime”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e ndihmësit në muratim dhe suvatim”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E NDIHMËSIT NË MURATIM DHE SUVATIM	MK-02- 402-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët me përshkrimin e veçorive të profesionit ndihmës në muratim dhe suvatim, me interpretimin e llojeve të ndryshme muratimi dhe suvatimi si dhe me përshkrimin e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	21 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit ndihmës në muratim dhe suvatim Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë detyrat, qëndrimet kryesore të punonjësit ndihmës në punime muratimi dhe suvatimi; - të përshkruajë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike; - të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes, pastrimit, sistemimit të veglave dhe vendit të punës; - të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit në grup; - të shpjegojë rëndësinë e raportimit rregullisht tek eprori për detyrën e dhënë; - të përdorë informacionet mbi zhvillimet e teknologjisë. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. RN 2 Kursanti interpreton lloje të ndryshme muratimi dhe suvatimi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të lexojë skica,detaje dhe simbole të thjeshta me fragmente punimesh në muratim dhe suvatim; - të interpretojë skicat e gatshme me lidhje muresh; - të interpretojë lloje të ndryshme muresh sipas materialeve ; - të skicojë lidhje te llojeve te ndryshme muresh;	

- të interpretoje llojeve të ndryshme muresh me tulla;
- të tregojë detajet e lidhjeve të rrjeshtave të murit ;
- të interpretojë llojet e shtresave të suvatimit;
- të dallojë llojet e suvatimi;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të listojë pajisjet mbrojtëse (PMI) në vendin e punës;
- të përshkruajë standardet dhe rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të përshkruajë rëndësinë e rregullores së brendshme, si dhe sinjalistikën e kantierit të ndërtimit;
- të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- të shpjegojë procedurën e evakuimit në raste emergjente;
- të përshkruajë rregullat përkatëse, gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- të sigurohet me mjetet e nevojshme për punimet në lartësi;
- të shpjegojë ndarjen e mbetjeve, sipas llojit;
- të shpjegojë mënyrën e transportimit të mbeturinave sipas llojit të ndarjes në vendin e duhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime muratimi dhe suvatimi.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit ndihmës në muratim dhe suvatim, të interpretojnë llojeve të ndryshme muratimi dhe suvatimi si dhe të përshkruajnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul si: përshkrimi i veçorive të profesionit ndihmës në muratim dhe suvatim, interpretimi i llojeve të ndryshme muratimi e suvatimi, si dhe përshkrimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kriterëve të vlerësimit të specifikuar

për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për muratim e suvatim
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Punime parapërgatitore në muratim ”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME PARAPËRGATITORE NË MURATIM	MK-02- 403-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të realizuar punime të ndryshme parapërgatitore në ndërtimin e mureve të ndryshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulën e parë “Hyrje në profesionin e ndihmesit në muratim dhe suvatim”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursanti parapërgatit materialet për muratim. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të veshi uniformën e punës dhe sigurojë skelën; - të ndihmojë në kontrollin dhe sigurimin e gjendjes teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës; - të përzgjedhi mjetet dhe materialet e punës për ndërtimin e mureve me tulla të ndryshme sipas manualeve të përdorimit; - të ndihmojë në sigurimin e ndriçimit të duhur dhe furnizimit me ujë; - të pastrojë e sistemojë paraprakisht vendin e punës para ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme; - të përgatisi tullat $\frac{1}{2}$, $\frac{3}{4}$ etj. sipas llojit të tyre. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgimi me listë kontrolli.
	RN 2	Kursanti ndihmon në nivelimin e themeleve për muratim. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të identifikojë mjetet që përdoren për nivelim (niveli, shirit matës, goma, shkopi matës); - të përdorë mjetet e nivelimit në mënyrë të saktë dhe të sigurt; - të ndihmojë në matjen, shënimin dhe kontrollin e nivelit të themeleve; - të zbatojë masat e mbrojtjes në punë gjatë punimeve në themele; - të tregojë përgjegjësi, kujdes dhe saktësi në kryerjen e detyrave; - të punojë në mënyrë bashkëpunuese me ekipin dhe të respektojë udhëzimet teknike. Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime muratimi e suvatimi.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Atyre duhet t'u jepen detyra të ndihmojnë në përgatitjen e materialeve e sipërfaqeve për muratim dhe ndihmojnë në parapërgatitjen e mjeteve për realizimin e muartimeve
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, si: të ndihmojnë në përgatitjen e materialeve e sipërfaqeve për muratim dhe ndihmojnë në parapërgatitjen e mjeteve për realizimin e muartimeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kritereve të vlerësimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënës.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet instrumentet dhe materiale pune dhe aksesoret përkatës për punime muratimi.
 - Katalogë, skica, detaje fletë projekti rregullore, manuale, udhëzues, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul
-

3. Moduli “Punime parapërgatitore në suvatim

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME PARAPËRGATITORE NË SUVATIM .	MK-02- 404-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët të ndihmojnë në përgatitjen e materialeve e sipërfaqeve për suvatim dhe ndihmojnë në parapërgatitjen e mjeteve për realizimin e suvatimeve	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulën e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në muratim dhe suvatim”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në përgatitjen e materialeve për suvatim Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të ndihmojë në prerjen e këndoreve sipas përmasave të dhëna; – të ndihmojë në përgatitjen e rrjetës telit sipas llojit të tavaneve; – të ndihmojë në përzgjedhjen e inerteve sipas llojit të llaçit; – të ndihmojë në përgatitjen e gëlqeres me ujë; – të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgimi me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në përgatitjen e sipërfaqeve për suvatim. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të ndihmojë në mbushjen e boshllëqeve të mureve e tavaneve me llaç çimento; - të pastrojë sipërfaqet nga bojrat, yndyrnat, llaçet e tepërta etj; - të kryejë realizimin e ashpërsisë së sipërfaqeve për suvatim; - të ndihmojë në mbulimin me rrjetë të difekteve të ndryshme para suvatimit; - të ndihmojë në vendosjen e këndoreve në këndet 90°; - të lagë me ujë sipërfaqet në rast nevojë para suvatimit; - të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;	

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në parapërgatitjen e mjeteve për suvatime

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në përgatitjen e betonjerës për punë;
- të ndihmojë në përgatitjen takove për suvatim;
- të ndihmojë në përgatitjen fashaturave për suvatim;
- të ndihmojë në përgatitjen e pompës së suvatimit;
- të përgatisë kubikët për përgatitjen e llaçeve;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime muratimi e suvatimi.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Atyre duhet t'u jepen detyra të ndihmojnë në përgatitjen e materialeve e sipërfaqeve për suvatim dhe ndihmojnë në parapërgatitjen e mjeteve për realizimin e suvatimeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, si : të ndihmojnë në përgatitjen e materialeve e sipërfaqeve për suvatim dhe ndihmojnë në parapërgatitjen e mjeteve për realizimin e suvatimeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet instrumentet dhe materiale pune dhe aksesori përkatës

për punime suvatimi.

- Katalogë, skica, detaje fletë projekti rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul
-

4. Moduli “Punime ndihmëse në muratim”.

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE NË MURATIM	MK-02- 405-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët në organizimin e punës në muratim, në ndërtimin e murit me tulla në lidhje në Formë “T” “L” dhe “+” si dhe në ndërtimin e xokolit dhe murit në lartësi me gur natyror.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulën e parë “Hyrje ne profesionin e ndihmesit në muratim dhe suvatim”.	
Rezultatet e të nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës në muratim. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të marrë detyrën e dhënë; – të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; – të zbatojë parimet e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë; – të ndihmojë në përcaktimin e radhës së kryerjes së punimeve të ndërtimit të mureve me tulla të ndryshme; – të veshi uniformën e punës dhe sigurojnë skelën; – të kontrollojë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës; – të ndihmojë në përzgjedhjen e mjeteve dhe materialeve e punës për ndërtimin e mureve me tulla të ndryshme; – të përdorë korrekt terminologjinë profesionale; – të ndihmojë në identifikimin e lidhjes së skelës me konstruksionin e ndërtesës; – të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirmbajë veglat dhe materialet e punës Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgimi me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në ndërtimin e murit të tullës në lidhje në Formë “T” “L” dhe “+” Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të ndihmojë në kryerjen e piketimit me spango të mureve në lidhje në formë “T” “L” dhe “+” (kryq); – të përgatite llaçin përkatës në raportin e duhur; – të ndihmojë në shtrimin e llaçit dhe vendosjen e tullave ; – të ndihmojë në kryerjen e lidhjes së murit me strukturat e ndryshme sipas detajeve të gatshme;	

- të ndihmojë të ndërtojë murin në lidhje në formë “T” “L” dhe “+” (kryq);
- të ndihmojë në pastrimin e fugave të llaçit;
- të ndihmojë në ndërtimin e brezave dhe kollonetave;
- të ndihmojë në kryerjen e dizarmimit të brezave dhe kollonetave;
- të pastrojë, mirëmbajë e sistemojë vendin e mjetet e punës pas ndërtimit të murit;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit me tulla të ndryshme .

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti ndihmon në ndërtimin e xokolit dhe murit në lartësi me gur natyror.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në vendosjen e gurëve duke i vendosur në pozicionin e kërkuar nga punëtori kryesor.
- të kryejë përzierjen dhe përgatitjen e llaçit
- të ndihmojë në shtrimin e llaçit, dhe vendosjen e gurëve.
- të ndihmojë në ndërtimin e xokolit me gurë deri në kuotën e duhur dhe kontrollin me instrumente matëse e niveluese;
- të ndihmojë në përpunimin e fugaturave të llaçit në kohën e duhur;
- të ndihmojë në ndërtimin e murit me gurë në lartësi.
- të pastrojë fugaturat e llaçit në kohën e duhur;
- të sistemojë, pastrojë dhe mirëmbajë mjetet e instrumentet e punës pas ndërtimit të murit me gurë;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të murit me gurë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime muri. Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore për punime të mureve me tulla të ndryshme, lidhje në formë “L”, “T” dhe “+”. dhe detajet e mureve me tulla, gure si dhe muret me tulla xhami, muret mbushëse e të përzier etj. Kursantët duhet të angazhohen në detyra konkrete pune për ndërtimin e mureve me tulla të ndryshme lidhje në formë “L”, “T” dhe “+”. dhe detajet e mureve me tulla, themele, xokola e mure në lartësi me gurë, muret mbushëse e të përzier si dhe muret me tulla xhami e blloqe .

	Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime muratimi . – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Punime ndihmëse në suvatim”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE NË SUVATIM	MK-02- 406-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët të ndihmojë në organizimin e punës për suvatime si dhe ndihmojë për realizimin shtresës parë, të dytë dhe tretë (finon) të suvatimit	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje ne profesionin e ndihmësit në muratim dhe suvatim”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës për suvatime. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të marrë detyrën e dhënë; – të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; – të përdorë korrekt terminologjinë profesionale; – të zbatojë parimet e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë; – të zbatojë radhën e punës për detyrën e dhënë, duke u konsultuar me specialistin; – të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave e mjeteteve të nevojshme për suvatime; – të kontrollojë veglat e punës para përdorimit të tyre; – të ndihmojë në identifikimin e lidhjes së skelës me konstruksionin e ndërtesës; – të pastrojë vendin e punës, sistemojë e mirëmbajë veglat dhe materialet e punës; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgimi me listë kontrolli. RN 2 Kursanti ndihmon në realizimin e shtresës e parë të suvatimit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të përgatisë me betonjere llaçin e çimentos në raportin e dhënë të përbërësve sipas udhëzimeve; – të ndihmojë në sperkatjen me pompe të shtresë së parë(spruco) sipërfaqet e tavaneve e mureve të brendshme; – të ndihmojë në sperkatjen me pompe të shtresë së parë(spruco) sipërfaqet e mureve te jashtme; – të ndihmojë në vendosjen e takove në sipërfaqet e mureve;	

- të ndihmojë në kontrollin e nivelimit të vendosjes së takove;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në realizimin e shtresës e dyte të suvatimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë llaçin për fashot drejtuese sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në formimin e fashove drejtuese në sipërfaqet e mureve;
- të përgatisë llaçin e përzier me betonjere në raportin e perbersve të dhënë sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në realizimin e shtresës e dyte te suvatimit duke mbushur me llaçin e përzier midis fashaturave;
- të ndihmojë në realizimin e prerjes me mastar, llaçin e tepërt midis fashaturave;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti ndihmon në realizimin e shtresës e tretë të suvatimit(fino)

- të përgatisë me ujë finon e gatshme sipas udhëzimeve;
- të spërkasë më furçë sipërfaqet e murit me ujë;
- të ndihmojë në realizimin e shtresës e tretë të suvatimit(fino);
- të ndihmojë në fërkimin me vegla dore e finos së hedhur në sipërfaqet e mureve
- të heqë finon e tepërt nga sipërfaqja e suvatuar;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime muratimi e suvatimi.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me

	objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për të ndihmuar në organizimin e punës për kryerjen e suvatimeve dhe ndihmojnë në realizimin e shtresës së parë, dytë dhe tretë të suvatimit(fino) - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, si: të ndihmojnë në organizimin e punës për kryerjen e suvatimeve dhe ndihmojnë në realizimin e shtresës së parë, dytë dhe tretë të suvatimit(fino) - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kriterëve të vlerësimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime suvatimi. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.